



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditë:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor i punës së komisionit
2. Shtyrtimi nen per nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Klotilda Bushka, Roland Xhelilaj, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku.

Mungojnë:

Almira Xhembulla.

Të ftuar:

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna – Drejtore e Programeve, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Ligjor

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ne vijmë pas një takimi të gjatë nga Konferenca e Urdhrit të Mjekut me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Urdhrit të Mjekut, e cila u zhvillua në *Tirana International Hotel*.

Ju e keni marrë me *e-mail* të gjithë agjendën për ditën e sotme.

Kalojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

A jeni dakord?

Miratohet.

Para se të vazhdojmë më tutje, unë doja të prezantoja anëtarët e rinj të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, zotin Evis Naço dhe doktor Edmond Stojku.

Ju uroj suksese në detyrën tuaj!

Së dyti, kemi kalendarin 3-javor të punës, të cilën e keni parë. Kush ka ndonjë ide nga grupi?

Kemi të planifikuar Kodin Penal, kemi romisionin për rininë, për të cilën po mblidhemi, kemi projektligjin “Për censusin e popullsisë dhe banesave”, në datën 14 Qershor kemi Ditën Botërore të Dhurimit të Gjakut, kemi një vizitë në universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, në datën 17 qershor është Dita Botërore e Parandalimit të Abuzimit ndaj të Moshuarve, kurse në datën 18 qershor kemi një vizitë në spitalin e Gramshit dhe në qendrën shëndetësore në Bashkinë e Gramshit. Për periudhën që mbetet, a keni ndonjë sugjerim?

A jeni dakord me kalendarin 3-javor?

Dakord.

Miratohet.

Kalojmë te shqyrtimi nën për nën i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. E theksojmë që në fillim ky projektligj është hartuar nga një grup deputetësh të Partisë Socialiste, Klodi bashkë me Edlirën, Klotildën dhe Ilirin, i cili po vjen, janë marrë me ligjin. Ky projekt ka kaluar në Komision të Ligjeve dhe ka ardhur në komisionin tonë për dhënie mendimi dhe pas dy takimesh që kemi bërë me grupet e interesit, por edhe një takim që kemi bërë si komision, ky është i katërti. Ne jemi të mendimit që, duke parë terrenin shqiptar, si dhe bazuar në Kodin e Procedurës Penale në Europë bashkë me

eksperiencën e shumë vendeve të tjera, neglizhenca në trajtimin mjekësor i të sëmurëve nga ana profesionale, shëndetësore i personelit ndihmës, kur ka rrezikuar jetën e personit apo ka i shkaktuar gjymtim të përhershëm, dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit. Po kjo vepër që ka shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burg deri në dy vjet.

A jeni dakord për këtë?

Kemi hequr fjalinë “Po kjo vepër, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me virusin HIV/AIDS, dënohet me burg deri në 3 apo 7 vjet”, sepse kemi këtu një raport të Shoqatës Kombëtare të Transfuzionit dhe të Shoqatës së Kombëtare të Sëmundjeve Infektive, që është doktor Arjan Harxhi, e cila, bazuar në eksperiencën e Kodit Penal në Europën Perëndimore, edhe në përvojën e të gjitha shoqatave të tjera europiane, ka argumentuar që të hiqet pika e tretë, pasi nuk përcaktohet dot dritarja e infeksionit për HIV/AIDS. Ju e keni një kopje të këtij materiali në dosjen tuaj, ku theksohet heqja e tij, si dhe ku thuhet që tashmë ekziston mjekimi për këto sëmundje, prandaj nuk përbëjnë më rrezik. Në kushtet e infrastrukturës në Shqipëri, nëse ai ka neglizhuar dhe rëndon gjendjen shëndetësore të pacientit, atëherë kapet te neni më sipër.

E lexoj edhe një herë: “Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e mjekut, ose e personelit tjetër mjekësor, kur ka dëmtuar rëndë shëndetin, ose ka rrezikuar jetën e personit, dënohet me gjobë ose me burg deri në një vit. Po kjo vepër, ku ka shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burg deri në 2 vjet”.

Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi kërkuar minimumin e mundshëm, jemi konsultuar edhe me një prokuror, të cilin e thirrëm javën e kaluar. Janë bërë takimet me shoqatat

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, me Urdhrin e Mjekut, me Urdhrin e Infermierit, me të gjitha urdhrat, me Shoqatën e Pacientëve, me Ministrinë e Shëndetësisë, me Universitetin e Mjekësisë dhe me të gjithë akademikët është trajtuar gjerë e gjatë kjo punë, është marrë dhe e gjithë eksperiencia e Kodit Penal në Europë dhe kemi tentuar të caktojmë minimumin e dënimit, për arsye se e dimë që infrastruktura e nevojshme model, siç është në Suedi, apo në vendet perëndimore, nuk është në Shqipëri. Atje gabimi i neglizhencës kapet, kurse në kushtet që jemi ne i bie të dënojmë të gjithë mjekët, ta lënë spitalin dhe të shkojnë të punojnë si mjekë në klinika private ose të ikin jashtë shtetit.

Mira Rakacolli – Unë jam Mira Rakacolli dhe jam Zëvendësministre Shëndetësisë e të Mbrojtjes Sociale. Ne kemi diskutuar disa herë edhe në këtë tavolinë dhe vë re një ndryshim në formulimin e nenit 96, ku shoh që varianti që kemi paraqitur është që neglizhenca në

trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e profesionistit shëndetësor ose personelit ndihmës, ka ndryshuar në: "...neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve nga ana e mjekut ose nga ana e personelit tjetër mjekësor". Do të doja një shpjegim, përse termi "profesionisti shëndetësor" është ndryshuar në termin "personelin tjetër mjekësor"? Çfarë nënkupton termi "personelin tjetër mjekësor", sepse përkufizimi se çfarë do të thotë "profesionisti shëndetësor" e shpjegon ligji "Për kujdesin shëndetësor".

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira Bode – Faleminderit!

Doktoreshë, e kemi diskutuar pak edhe te përkufizimi "profesionistët shëndetësor" kemi edhe profesione jomjekësore, si ekonomistë.

Mira Rakacolli – Në ligjin "Për kujdesin shëndetësor", që është miratuar nga parlamenti, thuhet që profesionistët shëndetësor janë personat e pajisur me dijet e nevojshme shkencore dhe profesionale, të cilët ushtrojnë profesionin në fusha dhe profile të ndryshme të sistemit shëndetësor.

Enver Roshi – Atëherë, ju hidhni idenë që të bëhet përsëri "ndihmës mjekësor"?

Mira Rakacolli - Ne e themi siç është te neni 96. Çfarë kuptohet me "personel tjetër mjekësor"?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ndihmës?!

Klotilda Bushka – Jam dakord me shqetësimin që ngre zonja Zëvendësministre. Le të nisemi nga qëllimi i nenit, të cilin e kemi thënë kur kemi paraqitur projektpropozimin e ligjit. Qëllimi ka të bëjë me rregullimin e një situatë më të favorshme për mjekët dhe këtu është bërë dekriminalizimi i gabimit mjekësor, duke lënë si vepër të dënueshme vetëm rastet kur mjeku sillet me neglizhencë. Po flasim për mjekët, për profesionistët e shëndetësisë. Nëse këtu qëllimi është të fusim edhe personel tjetër ndihmës që nuk është te profesionistët e shëndetësisë, atëherë kemi dalë nga qëllimi i propozimit. Kështu që, për mua propozimi i zëvendësministres është i saktë, duhet lënë "profesionistët e shëndetësisë" siç është te përkufizimi, dhe nëse, personat e tjerë, që nuk janë profesionistë shëndetësie, bëjnë gabime të tilla që dëmtojnë shëndetin e njerëzve, do të trajtohen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe quhet që kanë gabuar me detyrën dhe do të trajtohen siç trajtohet çdo punonjës tjetër në një zinxhir punësh në sektorë të ndryshëm. Ky nen parashikohet tekstualisht për mjekët, për profesionistët e shëndetësisë, prandaj mos i ngatërroni me subjekte të tjera të punësuar brenda institucioneve.

Edlira Bode – Ju e përsëritët termat "mjekët" dhe "profesionistët e shëndetësisë", por mjekët janë një gjë kurse profesionistët e shëndetësisë janë edhe jo mjekë, si, për shembull, infermierët. Prandaj aty është shkruar "personel mjekësor", por duhet ta përcaktojmë si do ta

themi: “personel shëndetësor” apo vetëm mjekë? Te “profesionistët e shëndetësisë” të përkufizuar të ligji “Për kujdesin shëndetësor” hyjnë mjekët, infermierët dhe kush tjetër?...

Mira Rakacolli – Janë të gjithë ata persona që kanë dijet e nevojshme shkencore për t’iu shërbyer njerëzve në drejtim të shëndetit, pra të gjithë ata që kanë diplomën e të gjitha shkencave mjekësore e teknike, duke përfshirë fizioterapistin, laborantin, imazhoristin etj.

Enver Roshi – A jeni dakord me propozimin?

Edmond Stojku – Unë quhem Edmond Stojku, jam mjek në profesion prej 32 vjetësh, jam marrë me administrim shëndetësor prej 15 vjetësh në disa nivele përfaqësimi. Për mua është më tepër e rëndësishme të ndajmë një herë e mirë personelin mjekësor me atë ndihmës, që do të thotë se ai që jep provimin e shtetit të Agjencia Kombëtare e Provimeve, quhet personel mjekësor, pra infermierë, laborantë, fizioterapistë, mjekë, stomatologë, etj. Këtë e ka ndarë shteti dhe kjo ka mbaruar. Ky është personeli mjekësor. Për mua është shumë e rëndësishme të ulet penalteti për mjekët, pasi, duke qenë mjek, absolutisht jam për reduktimin e të gjitha problematikave dhe në favor të mjekëve.

Po ashtu, është e rëndësishme të sugjerojmë marrjen e një nisme siç e ka e gjithë bota, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Europa Perëndimore, për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë për mjekët, sigurimin profesional. Pra, të mos i mëshojmë fort detyrimit të dënimit të mjekut ose të personelit mjekësor, qoftë edhe për gabimet dhe neglizhencën, duke përjashtuar rastet me dashje, sepse është penalteti i parashikuar nga Kodi Penal. Për rastet e neglizhencës dhe të paaftësisë profesionale mendoj të marrim një nismë për të negociuar, së pari, ne me veten, më pas me grupet e interesit dhe me profesionistët, për të arritur një kontur ligjor, i cili ...

Enver Roshi – Doktor, më fal, por është hequr kjo.

Edmond Stojku - Nuk e di pse e keni hequr, të them të drejtën.

Enver Roshi – “Gabimi mjekësor” është hequr.

Edmond Stojku – Pse është hequr? Në të gjithë botën, çdo mjek siguron...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është hequr nga Kodi Penal?

Enver Roshi - Është hequr.

Mbetet për t’u diskutuar në një mbledhje tjetër.

Edmond Stojku – Kjo është më e rëndësishme për personelin mjekësor se sa penalteti. Mendoj se penalteti për mjekun duhet të jetë sa më i vogël i mundshëm.

Enver Roshi - E riformulojmë edhe një herë.

Jemi dakord me përshkrimin e profesoreshë Mirës?

Të gjithë dakord.

Kalojmë në votimin nen për nen të Kodit Penal.

Neni 1, nuk ka gjë për të shtuar.

Miratohet.

Neni 2, me ndryshimet që bëmë ne.

Miratohet.

Neni 3.

Miratohet.

Neni 4.

Miratohet.

Neni 5.

Miratohet.

Neni 6.

“Pas nenit 201 shtohen nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/d, 201/e me këtë përmbajtje”.

Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 201/a, “Shkaktimi i fatkeqësive mjedisore”.

Miratohet.

Neni 201/b, “Menaxhimi i Mbetjeve”.

Miratohet.

Neni 201/c, “Transportimi i mbetjeve”.

Miratohet.

Neni 201/d, “Aktivitetet e rrezikshme”...

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, neni 7.

Miratohet.

Neni 8.

Miratohet.

Neni 9.

Miratohet.

Neni 10.

Miratohet.

Neni 11.

Miratohet.

Neni 12, paragrafi i tretë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – Siç u ndryshua neni 2 për përmbajtjen e nenit 96 të Kodit Penal, i njëjti ndryshim duhet bërë edhe te paragrafi i tretë i nenit 12, që ndryshon nenin ... Nuk e kemi në këtë material.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Cili nen është?

Këshilltarët, cili nen është, sepse nuk e keni vënë?

(Ndryshime pa mikrofon.)

Jo, një minutë.

Duhet të jetë neni 237.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vajza, ju lutem, herë tjetër, kur thoni “ndryshon paragrafi i tretë i nenit 12” dhe kur neni 12 ndryshon një nen ekzistues në ligjin që po flasim, shkruani “Neni 12, që ndryshon neni x të ligjit”, sepse, kur ta zbardhin zonjat, do ta kenë totalisht të vështirë ta kuptojnë.

Të përpiqem ta them edhe një herë.

Te paragrafi i ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Të bëhet në të ardhmen, por të përpiqemi tani ta themi të saktë.

Atëherë, te neni 12, i cili ndryshon nenin 237 të Kodit Penal, “Goditja me forcë”...

Ju lutem, ma verifikoni pak në Kodin Penal.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, te drafti që kam unë thuhet: “Mjekë, personel tjetër mjekësor”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta përmbylim.

Te neni 12, i cili ndryshon nenin 237, paragrafi i tretë, që flet për dhunën ndaj mjekut, të përkufizohet me perifrazimin e shprehjes, siç u bë te neni 2, që ndryshonte nenin 96. Të thuhet fjalët “profesionisti shëndetësor”.

(Mungesë incizimi.)

Mira Rakacolli– Mund të bëj një koment?

Për personelin duhet të mbrojmë edhe ...

Deri në 3 vjet e kemi për këtë, ndërsa këtë e kemi lënë deri në 1 vit. Më duket shumë e ulët.

(Diskutime pa mikrofon.)

Enver Roshi – Atëherë, e lëmë 1 deri në 3 vjet, siç është varianti ekzistues.

Jeni dakord me ndryshimet përkatëse?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mira Rakacolli – Propozimi i ministrisë është 1 deri në 3 vjet.

Enver Roshi – Miratohet.

Neni 13.

Pas neni 238 shtohet neni 238/a me këtë përmbajtje: “Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Te cili nen jemi tani?

(Diskutime pa mikrofon.)

E kap neni tjetër, sipas rastit.

(Mungesë incizimi.)

Neni 16.

Miratohet.

Neni 17.

Miratohet.

Neni 18.

Miratohet.

Neni 19.

Miratohet.

Neni 20.

Miratohet.

Neni 21.

Miratohet.

Neni 22.

Miratohet.

Neni 23.

Miratohet.

Kodi Penal u miratua me ndryshimet përkatëse. U miratua edhe në tërësi në Komisionin e Shëndetësisë.

Ju urojmë sukses në Komisionin e Ligjeve dhe në parlament.

Mbyllet mbledhja.

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe opinionet e dhëna!

MBYLLET MBLEDHJA